



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2022

V E N D I M

Nr. 84, datë 04.05.2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 64, datë 08.04.2022, e Shoqatës së Fëmijëve dhe të Rriturve me Diabet, ku pretendohet diskriminim, për shkak të gjendjes ekonomike, gjendjes shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar, si pasojë e parashikimeve të VKM-së nr. 940, datë 18.11.2015 “Për disa ndryshime ne Vendimin nr. 153, datë 07.04.2000, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit rrugor të Republikës së Shqipërisë””, të ndryshuar”, që parashikon rinovimin çdo 2 vjet të lejeve të drejtimit për personat me diabet.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri²,

K O N S T A T O I:

I. Pretendimet sipas subjektit ankues.

Shoqata e Fëmijëve dhe të Rriturve me Diabet ngre shqetësimin lidhur me parashikimet e Shtojcës 2, të Vendimit nr. 940, datë 18.11.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime ne Vendimin nr. 153, datë 07.04.2000, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë””, sipas së cilave personat që vuajnë nga diabeti duhet të kryejnë rinovim të lejes së drejtimit të automjetit (patentës) çdo 2 vjet.

Pretendimi për diskriminim i kësaj shoqate, që përfaqësohet pranë KMD-së nga Drejtori i saj Ekzekutiv, z. A.T., konsiston si vijon:

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

- Institucionet përgjegjëse nuk kanë kërkuar mendim, nuk janë konsultuar dhe nuk kanë bashkëpunuar me grupet e interesit, në rastin konkret me Shoqatën e Fëmijëve dhe të Rriturve me Diabet, gjatë procesit të hartimit të VKM-së së sipërcituar;
- Institucionet përgjegjëse nuk kanë marrë parasysh se sa i madh është komuniteti i individëve që vuajnë nga diabeti dhe se sa problematika i janë shtuar kësaj kategorie, duke u shtuar kostot ekonomike, shqetësimet e streset, lidhur me rinovimin çdo dy vjet të lejes së drejtimit të automjetit;
- Kostot për rinovimin e lejes së drejtimit të automjeteve për personat diabetikë janë 5-fishuar, në krahasim me personat e tjerë, të cilët kanë të detyrim të rinovojnë lejen e drejtimit të automjetit çdo 10 vjet;

Në ankesë theksohet fakti se, se diabeti është një ndër sëmundjet kronike tipike që përfaqëson sfidën epidemike më problematike të këtij shekulli. Sot në botë numërohen rreth 415.000.000 persona me diabet, pothuajse sa 1/3 e popullsisë globale. Në Shqipëri, numri i diabetikëve mendohet se është 86.000 individë, duke patur parasysh këtu edhe faktin se 10% të individëve, të cilët paraqesin diabet të fshehur. Në ankesë vihet në dukje fakti se diabeti është një sëmundje që të gjithë duhet ta pranojnë dhe të bashkëjetojnë me të gjithë jetën. Z. A.T. sqaron se ai zbaton me rigorozitet protokollin e kësaj sëmundjeje, duke ndjekur konsultat me mjekët specialistë dhe me mjekun e familjes, sipas protokollit shëndetësor. Ai shprehet se nuk i mban mend faturat e kostove të analizave, pasi nuk i janë kërkuar t'i mbledhë, por ka vënë re se këto kosto shtohen nga viti në vit, duke mos patur asnjë lehtësim. Ai shprehet se ndihet i diskriminuar, nga ndryshimet që ka sjellë VKM e sipërcituar në vitin 2015. Bashkëlidhur ankesës është depozituar edhe një pjesë e një studimi të vitit 2014 mbi diabetin, ku evidentohen edhe kostot e kësaj sëmundjeje. Z. A.T. shprehet se beson se aktualisht, këto kosto duhet të jenë rritur me 15%.

Ai shprehet se Shoqata që ai përfaqëson nuk është kundër procedurave të nxjerra në zbatim nëpërmjet VKM-së së sipërcituar, por këto detyrime kanë kosto shëndetësore, ekonomike dhe vështirësi në marrjen e lejes nga punëdhënësi për të ndjekur procedurën. Ai shprehet se personat diabetikë zhvillojnë konsulta me mjekun endokrinolog çdo 3 muaj, takim me okulistin çdo 6 muaj, fakt që tregon se personat diabetikë kanë kontroll të plotë mbi shëndetin e tyre me frekuencë më të shpeshtë se sa periudha 2 vjecare. Por tani janë shtuar ecejaket stresuese nëpër rradhët e gjata dhe kostot ekonomike për dokumentacionin e mëposhtëm:

- Komisioni për certifikatën mjekësore (1.000 lekë);
- Marrja e rekomandimeve tek mjeku i familjes për vizitën e syve dhe të veshëve dhe për mjekun endokrinolog, duke kryer planifikimin përkatës si dhe plotëson certifikatën mjekësore;
- Kryerja e vizitës për sytë dhe veshët tek mjekët okuliste dhe ORL (3.000 lekë);
- Marrja e rekomandimit tek mjeku endokrinolog për komisionin në Poliklinikën Qendrore;

- Dorëzimi i dokumentacionit përkatës për lejen e drejtimit të automjetit dhe pagesa për kartonin prej 3.500 lekësh

Në këtë kontekst, z. A.T. ngre pyetjen se nëse një pacient rezulton i rregullt me pikat e parashtruara më lart, përse duhet t'i jepet patenta për 2 vite dhe me kosto shtesë, 5 herë më tepër sesa atij që i jepet leja e drejtimit të automjetit për një periudhë 10 vjeçare.

Subjekti ankues vë në dukje faktin se në shumë vende të botës, procedura e marrjes së lejes së drejtimit të automjetit për personat që vuajnë nga diabeti konsiston në kryerjen e kontrolleve të syve, veshëve, ecurisë së sheqerit në gjak në 3-6 muajt e fundit, si dhe komplikacionet e tjera të shkaktuara nga diabeti nëse ka të tilla. Në vijim, një komision mjekësh cakton nëse një person është i aftë të marrë lejen e drejtimit dhe vlefshmërinë e saj në kohë, në varësi të rezultateve të tij pas kontrolleve.

II. Procedurat e ndjekura nga Komisioneri

Pas kryerjes së verifikimit paraprak të ankesës dhe akteve bashkëlidhur saj, KMD gjykoj se kjo ankesë duhet plotësuar me informacion. Për këtë arsye, KMD iu drejtua me e-mail ankuesit në datën 19.04.2022, ku iu kërkua informacioni vijues:

1. *“Të përcaktohet qartë nëse ankesa e depozituar pranë KMD-së është ankesë juaja individuale (si individ dhe njëkohësisht si anëtar/drejtor ekzekutiv i shoqatës) apo ankesë e shoqatës që ju përfaqësoni, për të gjithë kategorinë e personave që vuajnë me diabet. Nëse është kjo e fundit, lutemi të paraqiten disa raste, ku persona me diabet kanë paraqitur problematika si pasojë e aplikimit të VKM-se nr. 940/2015;*
2. *Të përcaktohet qartë subjekti/tet që ka/në kryer diskriminimin;*
3. *Të provohet me fakte dhe prova konkrete momenti i marrjes dijeni mbi diskriminimin e pretenduar, i cili duke iu referuar formularit të plotësuar nga ana juaj, përkon me datën 20.10.2019;*
4. *Të jepen shpjegime në mënyrë të qartë, se ku qendron diskriminimi i pretenduar, për shkaqet e sipërcituara, në VKM-në nr. 940/2015. Të përcaktohen nenet e kësaj VKM-je që ju i pretendoni si diskriminuese, duke parashtruar kundërshtimet tuaja ndaj tyre;*
5. *Të depozitohet në cilësi prove çdo letërkëmbim zyrtar me institucionet kompetente, ku ju/shoqata që ju përfaqësoni, ka adresuar për zgjidhje problematikat që ju i konsideroni diskriminuese ndaj kategorisë së personave që vuajnë me diabet, si pasojë e dispozitave të VKM-së së sipërcituar.*
6. *Të dërgohet çdo informacion tjetër që e konsideroni të nevojshëm për objektin e ankesës së parashtruar pranë Komisionerit.”*

- Në përgjigje të e-mailit të dërguar nga Komisioneri, ankuesi dërgoi e-mailin e datës 23.03.2022, ku citohet:

“Unë kam bërë një kërkesë pranë jush, duke përkuar dhe pozicioni im dhe si Drejtor Ekzekutiv i Shoqates së Fëmijëve dhe të Rinjve me Diabet.

Ndoshta nuk e kam hartuar dhe nuk e di nëse kam bërë mirë, në qoftë se kam bërë mirë që kam marrë atributin e kësaj gjithsesi, shqetësimi qendron. Deri sa është tek unë, është dhe tek anëtarët e tjerë që e qajnë dhe stërfaqjnë këtë opinion. Dhe nese duhet kaq zyrtarisht, do të më vendosni para një përgjegjësie që t'i mbledh kërkesat dhe të bëjmë të njëjtën gjë. Për mua duket e tepërt. Une arrij në një përfundim:

-Ndihem i diskriminuar!!!

Nga se ndihem i diskriminuar? Ne, në vetvete si grup vulnerabël ndihemi të diskriminuar nga fuqi ploti duke na dhënë një problem, dhe ne nga shoqëria apo instancat e shoqërisë presim lehtësim të barrës duke mos mohuar se ka bërë pak, por vijmë tek thelbi. Patenta jonë.

Patenta jonë rinovohet çdo dy vite. N.q.s unë do të vihesha paralel me një individ të zakonshëm, atij do t'i duhet ta nxirrte patentën çdo 10 vite. Ngrihet një pikëpyetje: Shteti e bën për të më mbrojtur mua? Nqs po, i faleminderit, por do të kishte mundësi që ta bënte duke na eliminuar kostot ekonomike. Jam gati të shkoj çdo vit të bëj analiza nëse do t'i kisha falas, por nga momenti që më detyron të paguaj, mendoj se nuk është e drejtë. Leja e drejtimit nuk është lluks, por një mjet lëvizës për të mbajtur veten në tregun e punës, dhe ne detyrohemi të paguajmë. Brenda 10 vjeçarit unë paguaj 5-fishin e shokut.

Nuk jam në gjendje, sepse nuk jam i fushës përkatëse për të parë fiks se ka nene apo paragrafe dhe nuk e di nqs duhet të marr ndonjë avokat apo duhet duhet ti drejtohem Avokatit të Popullit për tja u bërë dhe juve me të lehtë nqs ju nuk do të dinit ku të hulumtoni dhe të gjeni shkeljet që dhe ku të gjeni shkeljet që unë mendoj dhe e kam opinion.

Mendoj si opinion, por edhe ju vetë si njeri kur shikoni që duhet të paguaj koston e zakonshme të një herë në 10 vjet çdo dy vite, nuk besoj se pajtohem me koston time më të lartë. Jam gati të dal në komision çdo vit, por jo me kosto të shtuar sidomos nëse kostot tona janë tashmë më të larta se të një individit të zakonshëm.”

Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të gjendjes ekonomike, gjendjes shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose

shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 3, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në nenin 33, pika 4, gërmat dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet se ankesa nuk pranohet kur: “.... (dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese.” Parashikimi i sipërcituar nuk është kumulativ dhe kërkon si kriter për mospranimin e ankesës, plotësimin e njërës prej kushteve të mësipërme.

Për sa më sipër, referuar formularit të ankesës të plotësuar nga subjekti ankues, rezulton se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur në datën 18.11.2015, periudhë që përkon me miratimin e VKM-së nr. 940, datë 18.11.2015 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 153, datë 07.04.2000, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë””, të ndryshuar”. Mbështetur në sa më sipër rezulton se ankesa nr. 64, datë 08.04.2022, e Shoqatës së Fëmijëve dhe të Rriturve me Diabet është depozituar pranë

KMD-së, më vonë se 3 vjet nga ndodhja e diskriminimit. Referuar sërish formularit të ankesës rezulton se koha kur subjekti ka marrë dijëni mbi diskriminimin e pretenduar është **20.10.2019**, i cili përkon përafërsisht me shkresën nr. 188 prot., datë 01.10.2019, që kjo shoqatë ka dërguar në adresë të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Transportit Rrugor dhe për dijëni Ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shefit të Endokrinologjisë në QSUT. Ky moment rezulton gjithashtu, jashtë afatit ligjor të parashikuar në nenin 33, pika 4, gërma dh), pasi ankesa është depozituar pranë KMD-së, më vonë se dy vjet nga marrja dijëni për sjelljen diskriminuese

Mbështetur në dispozitën e sipërpërmendur, Komisioneri nuk e pranon për shqyrtim ankesën nr. 64, datë 08.04.2022, e Shoqatës së Fëmijëve dhe të Rriturve me Diabet, pasi është jashtë afateve ligjore për t'u shqyrtuar nga ky institucion.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 7, pika 3, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma b), nenin 33, pika 4, gërma dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 64, datë 08.04.2022, së Shoqatës së Fëmijëve dhe të Rriturve me Diabet, pasi është depozituar jashtë afateve ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha – të mira dhe shërbime
Shkak – gjendja ekonomike, gjendja shëndetësore dhe aftësi e kufizuar
Lloji vendimit - mospranim